



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3215 Prot.

Patos, më 30/12/2023

RAPORT VJETOR PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2022

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik ne Bashkine Patos gjatë vitit 2022 eshte bazuar në parimet e mëposhtme:

- a) *transparencë gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik*
- b) *pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;*
- c) *efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike;*
- d) *përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.*

Procesi është realizuar në zbatim të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Rregullores së Këshilli Bashkiak “ Për konsultimin publik” Bashkia Patos, Këshilli i Bashkisë.

Bashkia (Ekzekutivi) dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkërenduar për të ralizimin e një procesi konsultimi efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Gjatë vitit 2022, janë realizuar 30 dëgjesa me banorë në qytetin Patos dhe në NJA Zharrëz dhe Ruzhdije.

Gjate vitit 2022, Bashkia Patos bashkëpunoi me Projektit STAR 3, permes Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, per te rritur cilesine dhe ligjshmërinë e procesit te konsultimit publik . Te gjitha seancat konsultuese/dëgjesat jane pasqyruar gjerësisht në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Patos, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak si dhe për here të pare në Platformen: www.konsultimivendor.al në faqen e dedikuar Bashkise Patos brenda kesaj platforme (<https://konsultimivendor.al/patos/>). Bashkia Patos u përzgjodh bashkë me 6 bashki të tjera për të pilotuar dhe konsoliduar një praktikë konsultimi që do të shërbejë si model edhe për bashkitë e tjera të Shqipërisë.

Ky Raport Vjetor është hartuar nga Bashkia Patos në zbatim te detyrimeve qe cakton per autoritetin publik neni 20 i ligjit 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”. Sipas parashikimeve te ketij neni, organet publike hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) *numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;*
- b) *numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;*
- c) *numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit;*
- ç) *numrin e takimeve publike të organizuara.*

➤ **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2022.**

Këshilli Bashkiak Patos miratoi gjithsej 95 vendime gjate vitit 2022¹ te cilat gjendet të publikuara në faqen dedikuar bashkisë Patos në VENDIME.AL, integruar në faqen zyrtare të bashkisë Patos.

➤ **Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 45 rekomandime konkrete

➤ **Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:**

Nga 45 rekomandime, u mbajtën parasysh 33 dhe 12 u kthyen me motivim të arsyetuar nga zyrtarët publikë që u angazhuan në organizimin/drejtimin e dëgjesave

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara:**

1. Dëgjesë publike realizuar në fshatin Gjinoqarë, Njësinë Administrative Ruzhdie, datë 18.01.2022, procesverbali nr. 121/2 Prot me temë **“Diskutimi i rregullores së Konsultimit për Këshillin Bashkiak”**. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshilit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave të Njësisë Ruzhdie; Banorë të zonës.
2. Dëgjesë publike realizuar në Njësinë Administrative Zharrëz, datë 19.01.2022, procesverbali me nr. 121/3 Prot me temë **“Diskutimi i rregullores së Konsultimit për Këshillin Bashkiak”**. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshilit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave të Njësisë Zharrëz; Banorë të zonës
3. Dëgjesë Publike realizuar në ambientet e Palatit të Kulturës Patos datë 21.01.2022, procesverbali me nr. 3297/1 Prot, me temë **“Fillimi i procedurës së provatizimit të objektit ish-zyrat e NFP-së, pasuria nr. 6/15”**. Në takim morën pjesë: Përgjegjëse e Sektorit Juridik; Përfaqësues të zyrës së Shërbiit Social; banuesit banorë të objektit me nr. 6/15 pasurie.
4. Dëgjesë publike realizuar në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, datë 24.01.2022, procesverbali me nr. 121/4 Prot me temë **“Diskutimi i rregullores së Konsultimit për Këshillin Bashkiak”**. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshilit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave; Banorë të qytetit dhe përfaqësues të shoqërisë civile
5. Dëgjesë publike realizuar në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, datë 17.02.2022, procesverbali me nr. 325/1 Prot me temë **“Miratimi i kriterëve dhe procedurave te perzgjedhjes se anëtarëve të Komisionit Vendor të Rinisë”**. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshilit Bashkiak; Të rinj të qytetit; përfaqësues të shoqërisë civile; Drejtues i INFOCIP; dhe përfaqësues të ekzekutivit të bashkisë
6. Dëgjesë publike realizuar në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos datë 16.03.2022, procesverbali me nr. 470/2 Prot me Teme: **“Diskutim i procedurës për licensimin dhe**

¹ Vendimet e vitit 2022 mund te shihen ne likun: <https://www.vendime.al/category/patos-vendime-te-keshillit-bashkiak/2022-patos-vendime-te-keshillit-bashkiak/>

- ***rilicensimin e subjektit taksi 4+1 dhe 8+1***. Në takim morën pjesë: Përfaqësues të shërbimit taksi 4+1 dhe 8+1; Drejtor i hartimit të projekteve në bashki; Koordinator i të Drejtës për Informim dhe përfaqësues të bashkisë
- 7. Dëgjese publike realizuar në Njësinë Administrative Zharrëz, datë 08.04.2022, procesverbali me nr. 830/1.1 Prot me temë ***“Krijimin e ambienteve për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fermeret”***. Në takim morën pjesë: Drejtorja e bujqësisë; përfaqësues të shoqërisë civile; Kryetarë të fshatrave të; Fermer të zonës
- 8. Dëgjese publike realizuar në Njësinë Administrative Zharrëz, datë 14.04.2022, procesverbali me nr. 830/2.1 Prot me temë ***“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2023-2025”***. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshilit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave të Njësisë Zharrëz; Banorë dhe Fermerë të zonës dhe përfaqësues të projektit “Bashki të Forta”
- 9. Dëgjese publike realizuar në Njësinë Administrative Ruzhdië, datë 19.04.2022, procesverbali me nr. 830/2. 2 Prot me temë ***“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2023-2025”***. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshilit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave të Njësisë Ruzhdië; Banorë dhe Fermerë të zonës si dhe përfaqësues të ekzekutivit të bashkisë
- 10. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos, datë 21.04.2022, procesverbali me nr. 830/2.3 Prot me temë ***“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2023-2025”***. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshilit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave dhe banorë të qytetit si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe shoqërisë civile.
 - ***Raporti mbi fazën e parë të dëgjesave publike lidhur mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm për vitin 2023-2025. Procesverbali nr. 830/3 datë 26.04.2022***
- 11. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit Patos , datë 24.05.2022, procesverbali me nr. 1141/3.1 Prot me temë: ***“Marrja e mendimit për përsimërimin e infrastrukturës së Qenrës Kulturore të Fëmijëve Patos”***. Në takim morën pjesë: Drejtore e Integritimit Evropian; Përfaqësues të ZVA Patos; Drejtore e QKF-së Patos; Prëndër të fëmijëve që frekuentojnë QKF-në; Grupi i menaxhimit të projektit.
- 12. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Njësisë Administrative Zharrëz datë 17.05.2022, procesverbali me nr. 1141/1.1 Prot me temë ***“Diskutimi i projekt dokumentit të parë të PBA-së 2023-2025”***. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos; Banorë dhe Kryetarë të fshatrave të Njësisë Zharrëz; Përfaqësues të shoqërisë civile.
- 13. Dëgjese publike realizuar në fshatin Gjinoqarë Njësia Administrative Ruzhdië, datë 18.05.2022, procesverbali me nr. 1141/2.1 Prot me temë ***“Diskutimi i projekt dokumentit të parë të PBA-së 2023-2025”***. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos; Banorë dhe Kryetarë të fshatrave të Njësisë Ruzhdië; Përfaqësues të shoqërisë civile
- 14. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos, datë 20.05.2022 , procesverbali me nr. 1141/1.3 Prot me temë ***“Diskutimi i projekt dokumentit të parë të PBA-së 2023-2025”***. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos; Banorë dhe

Kryetarë të fshatrave të qytetit, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të projektit “Bashki të Forta”

15. Dëgjese Publike e realizuar ne ambientet e Njesisë Administrative Ruzhdie, datë 01.07.2022, procesverbali me nr.1456/2 Prot me temë “ **Diskutim për lidhjen e kontratës së qirasë ndërmjet Bashkisë Patos dhe OST sh.a për përdorimin e fondit kullosor nën administrimin e Bashkisë Patos në unksion të zgjerimit të linjës ekzistuese 220 kv Fier**”. Në takim morën pjesë : anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos; banorë dhe Kryetarë të fshatrave të Njesisë Ruzhdie, përfaqësues të Shoqërisë Civile; përfaqësues të KVR-së..
16. Dëgjese Publike realizuar në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz, datë 06.07.2022, procesverbali me nr. 1489/2.1 Prot me temë “ **Rikonstrukcion dhe adaptim i kopshtit Verbas në qendër ambulatorë**”. Në takim morën pjesë: Banorë të fshatit Verbas; Kryetar të fshatrave të Njesisë Zharrëz; Përfaqësues të DROSKSH-së Vlorë; Përfaqësues të NJVKSH-së Fier; përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë.

Me kërkesë të DROSKSH-së Vlorë, në datë 15.07.2022 është realizuar takimi informues me teme Prot me temë “ **Rikonstrukcion dhe adaptim i kopshtit Verbas në qendër ambulatorë**” vetëm me banorë kufitarë të objektit. procesverbali me nr.1489/2.2. Të pranishëm në taim ishin: Kryetar i fshatit Verbas; Banrë kufitar me godinën kopshti i fëmijëve Verbas; Administratore e Njesisë Zharrëz.

17. Dëgjese Publike e realizuar në fshatin Grizë Lënginas datë 08.07.2022, procesverbali me nr. 1489/3.1 Prot me temë “ **Sistemin i hapësirave rekreative të shkollës Grizë**”. Në takim morën pjesë: Përfaqësues të ZVA Patos; banorë të fshatit Grizë; përfaqësues të shoqërisë civile; përfaqësues të ekzekutivit të bashkisë
18. Dëgjese publike realizuar në lagjen “ e Re” (Banesat Sociale Ish qendra e kualifikimit shkalla 1 dhe 2) datë 29.07. 2022 procesverbali nr. 1489/6 me temë “**Tranzicion i energjisë” projekt bashkëfinancimi midis Bashkimit European,GIZ-it dhe Bashkisë Patos**. Në takim morën pjesë: banues në Banesa Sociale për Gratë kryefamiljare; Banues në banesa sociale për familjet në nevojë shkalla 1 dhe 2; përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë Patos².
19. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Njesisë Administrative Zharrëz, datë 02.09.2022 procesverbali nr. 1977/2 me temë “**Rishikim i kërkesave buxhetore për hartimin e PBA-së 2023-2025 dhe Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2023**”. Në takim morën pjesë: Banorë dhe Kryetar të fshatrave të Njesisë Zharrëz; përfaqësues të Shqërisë civile; përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë.
20. Dëgjese publike realizuar në njësinë Administrative Ruzhdie, datë.06.09.2022 procesverbali nr.1977/3 me temë “**Rishikim i kërkesave buxhetore për hartimin e PBA-së 2023-2025 dhe Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2023**”. Në takim morën pjesë: Banorë dhe kryetarë të fshatrave të Njesisë Ruzhdie; përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë Patos

²Linku i paqyrimit: <https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-takim-informues-per-projektin-tranzicioni-i-energjisë-bashkëfinancim-i-be-giz-dhe-bashkisë-patos/>

21. Dëgjese Publike realizuar në ambientet e pallatit të Kulturës Patos datë 08.09.2022 procesverbali nr.1977/4 me temë **“Rishikim i kërkesave buxhetore për hartimin e PBA-së 2023-2025 dhe Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2023”**. Në takim morën pjesë: Banorë dhe Kryetarë të fshatrave të qytetit; përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë

➤ **Raporti mbi fazën e dytë të dëgjesave publike lidhur mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm për vitin 2023-2025. Procesverbali nr. 1977/5 Prot datë 10.09.2022.**

22. Dëgjese Publike realizuar në fshatin Kuqar datë 30.09.2022 procesverbali nr.2243/ mbi projektin : **“Unaza Rurale Rikonstruksioni i rrugës Dukas – Kuqar, Manekaj – Rusinjë”**. Në takim morën pjesë: Banorë dhe Kryetarë të fshatrave pjesë e gjurmes së projektit; përfaqësues të KVR-se dhe grupe interesi si dhe përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë.

23. Dëgjese publike realizuar në fshatin Gjinoqarë, Njësia Administrative Ruzhdie, datë 20.10.2022, procesverbali nr. 2304/2.1 Prot me temë **“ Ngritja e një pike grumbullimi për ullirin”**. Në takim morën pjesë; Zv. Kryetare e Bashkisë; Përfaqësues të këshillit Bashkiak; banorë të Njesisë Ruzhdie, kujtivirus të Ullirit; Fermerë; INFOCIP dhe Koordinatori lokal i UNDP-së. Procesi është pasqyruar plotësisht online në www.konsultimivendor.al³ si dhe është dokumentuar me foto/audio/video⁴.

24. Dëgjese publike realizuar në Njësinë Administrative Zharrëz, datë 24.10.2022, procesverbali nr.2304/3.1 me temë **“ Prezantimi i Paketës Fiskale për vitin 2023”**. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos; përfaqësues të subjekteve private dhe fermerë të zonës; kryetarë të fshatrave të Njesisë Zharrës dhe përfaqësues të ekzekutivit.

25. Dëgjese publike realizuar në fshatin Gjinoqarë, Njësia Administrative Ruzhdie, datë 26.10.2022, procesverbali nr.2304/3.2 me temë **“ Prezantimi i Paketës Fiskale për vitin 2023”**. Në takim morën pjesë Anëtarë të këshillit të Bashkisë Patos; përfaqësues të subjekteve private dhe fermerë të zonës; kryetarë të fshatrave të Njesisë Ruzhdie; përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të ekzekutivit.

26. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos, datë 28.10.2022, procesverbali nr.2304/3.3 me temë **“ Prezantimi i Paketës Fiskale për vitin 2023”**. Në takim morën pjesë: Kryetarë dhe Anëtarë të këshillit të Bashkisë Patos; përfaqësues të subjekteve private që operojnë në territorin e Bashkisë Patos; banorë dhe kryetarë të fshatrave të qytetit; përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të ekzekutivit.

27. Dëgjese Publike realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit të Bashkisë Patos, datë 23.11.2022, procesverbali me nr.2657/2 me temë **“Rikualifikimi urban, blloku i lagjes Naftëtari pranë shkollës 9-vjecare Muhamet Shehu dhe Rikonstruksion i shkollës Muhamet Shehu dhe ndërtimi i palestrës”**. Në takim morën pjesë: anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos; Drejtore e Drejtorisë Arsimore Fier; Drejtore e ZAV Patos; banorë të lagjes

³ <https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-degjese-me-fermere-me-teme-ngritja-e-nje-pike-grumbullimi-per-ullirin/>

⁴ <https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-degjese-me-fermere-me-teme-ngritja-e-nje-pike-grumbullimi-per-ullirin-2/>

Naftëtari; prindër të fëmijëve të cilë frekuentojne shkollën Muhamet Shehu; drejtori Ekzekutiv i INFOCIP dhe ekzekutivi i Bashkisë. Procesi është pasqyruar plotësisht online ne www.konsultimivendor.al⁵ si dhe është dokumentuar me foto/audio/video⁶

28. Dëgjese Publike realizuar në fshatin Gjinoqarë, datë 02.12.2022, procesverbali me nr. 2818/2 Prot me temë **“Realizimi i Buxhetit për vitin 2022 dhe prezantimi i buxhetit për vitin 2023”** në takim morën pjesë : Kryetare e Bashkisë Patos; anëtarë të Këshillit Bashkiak; Femerë të zonës; banorë dhe Kryetarë të fshatrave të Njësisë Ruzhdie
29. Dëgjese Publike realizuar në fshatin Zharrëz Njësia Administrative Zharrëz, datë 05.12.2022, procesverbali me nr. 2818/3 Prot me temë **“Realizimi i Buxhetit për vitin 2022 dhe prezantimi i buxhetit për vitin 2023”** në takim morën pjesë : Kryetare e Bashkisë Patos; anëtarë të Këshillit Bashkiak; Mësues; banorë dhe Kryetarë të fshatrave të Njësisë Zharrëz.
30. Dëgjese Publike realizuar në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos, datë 07.12.2022, procesverbali me nr. 2818/4 Prot me temë **“Realizimi i Buxhetit për vitin 2022 dhe prezantimi i buxhetit për vitin 2023”** në takim morën pjesë : Kryetare e Bashkisë Patos; Kryetarë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të Shoqërisë Civile, banorë dhe Kryetarë të fshatrave të qytetit

Konceptoi:

Koord.Konsult.Publik
Suzana HYSENAJ



⁵ <https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetari-prane-shkolles-muhamet-shehu/>

⁶ <https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-konsultim-publik-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetari-prane-shkolles-muhamet-shehu/>